

AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “NATURA THERAPY.AL” Sh.p.k.

Ne baze te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite trgetare” dhe atij nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, me vullnetin e tyre te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij Akti, sot me date 28/03/2023 ,themeluesit e ketij Akti Themelimi,ne zoterim te plote te aftesive te tyre ,shprehur me firmen e tyre sot me dt 28/03/2023.

- **Gerta Demiri**, atesia Muharrem, shtetase shqiptare, identifikuar me ane te pasaportes me nr: BG2917194 dhe nr personal identifikimi: J85821066Q, e datelindjes 21/08/1998, lindur ne Burrel dhe banuese ne Tirane, madhore ne moshe dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Deklarojne se deshirojne te nenshkruajne kete Akt Themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “**NATURA THERAPY.AL**” shpk aktivitetit i shoqerise do te rregullohet nga Akti i Themelimit, Statuti dhe ligjislacioni shqiptar per shoqerite tregtare.

NENI 1


Formohet shoqeria tregtare e emertuar “**NATURA THERAPY.AL**” shpk me themelues znj. Gerta Demiri

NENI 2

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesvet te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 3

Shoqeria e ka seline e saj ne Rruga “Petro Cani (K. Manastirit)”, Kati i Pare, nr pasurie 1/461-N5, zone kadastrale nr 8130. Ajo mund te çele dhe seli te tjera te treta, dege e filiale, perfaqesi ne te gjithë territorin e R.SH, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.



NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet.

NENI 5

Objekti i veprimtarise do te jete :

- Call Center. Import – Eksport, tregti me pakice i artikujve industrial, kozmetike, ushqimor, produkteve me baze bimore dhe suplementeve ushqimore.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke dhe perbehet nga 1 kuote nga 100000 leke. Siaps kontributeve te shoqerise kapitali perbehet 100 % nga Gerta Demiri.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortaket mund t'u shesin te treteve kuotat e kapitalit pjeserisht ose teresisht te parashikuara nga ligji nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite trgetare dhe nga statuti i shoqerise.

NENI 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje "**NATURA THERAPY.AL**" shpk Tirane, Albania.

NENI 10


Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- Asambleja e Ortakeve
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

NENI 11

Ne castin e themelimit emerohet nga Asambleja e ortakeve si Administrator i shoqerise "**NATURA THERAPY.AL**" shpk, per mandatin e pare pese vjecar (i rinovueshem) Znj. Gerta Demiri.



NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te caktuara nga Banka e Shqiperise. Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i mbetet ne perdorim te ortakeve te saj duke u shperndare ne menyre te njetrajtshme sipas perqindjeve te parashikuara ne nenin 6, mbasi te jene likujduar te gjitha te gjitha detyrimet e te jete hequr fondi rezerves ligjore.

NENI 14

Akti u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila, per t'u depozituar ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKU I VETEM

GERTA DEMIRI

Gerta Demiri
